

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR FSHIRJEN, SHUARJEN DHE PAGESËN E DETYRIMEVE TATIMORE NDAJ ADMINISTRATËS TATIMORE QENDRORE E TË DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj është konceptuar si një masë e domosdoshme për të adresuar situatën e mbartur të detyrimeve tatimore dhe të detyrimeve të pagueshme në doganë të papaguara, të cilat, të akumuluar ndërmjet viteve, kanë krijuar një barrë financiare për subjektet ekonomike e për individët, por edhe një barrë administrative për vetë administratën tatimore dhe doganore.

Qëllimi i tij është të lehtësojë këtë barrë, të krijojë hapësirë për formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të përmirësojë klimën e biznesit në vend. Përmes këtij projektligji synohet që të fshihen, të shuhen ose të paguhen me lehtësi të konsiderueshme detyrimet, që në një pjesë të madhe të rasteve janë bërë të papagueshme për shkak të penaliteteve të larta, kamatëvonesave apo vështirësive të vazhdueshme financiare të vetë tatimpaguesve.

Në këtë mënyrë, projektligji synon të nxisë rikthimin e subjekteve në aktivitet të rregullt ekonomik, të ulë stokun e borxhit të pashlyer dhe të nxisë pagesën vullnetare të detyrimeve aktuale, duke ndikuar pozitivisht në marrëdhëniet ndërmjet tatimpaguesve dhe administratës tatimore e doganore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje me programin qeverisës 2025-2029, shtylla II – rritja ekonomike e qëndrueshme, pika 2.1, financat publike dhe politika fiskale, në të cilën është përcaktuar se: “Çelim një kapitull të ri bashkëpunimi me sipërmarrjen shqiptare përmes marrëveshjeve disavjeçare të lehtësimit tatimor dhe nxitjes së deklarimeve të rregullta duke zbatuar “Paqen fiskale” 2026– 2029, faljen e detyrimeve tatimore më të vjetra se 10 vjet, skemën e ripagimit të borxheve të 10 viteve të fundit me përqindje të reduktuara”.

Ky projektligj nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve të

Këshillit të Ministrave, për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Një numër i madh detyrimesh tatimore dhe detyrimesh të pagueshme në doganë është akumuluar ndër vite, duke u kthyer në një sfidë të dyfishtë: nga njëra anë, ato përbëjnë një pengesë për subjektet që duan të formalizojnë ose rifillojnë aktivitetin ekonomik, ndërsa nga ana tjetër, ato janë të vështira për t'u mbledhur nga administrata, duke u shndërruar në shifra praktikisht të pambledhshme për buxhetin e shtetit. Kjo situatë ka krijuar një klimë pasiviteti, ku shumë tatimpagues, të ngarkuar me borxhe të vjetra, nuk janë më pjesë aktive e sistemit ekonomik.

Projektligji sjell disa përparësi të qarta:

1. Lehtëson barrën tatimore për një numër të madh subjektsh dhe individësh;
2. Krijon mundësinë për të rikthyer në aktivitet të rregullt ekonomik subjekte, që përndryshe do të mbeteshin të paaktivizuar;
3. Ul stokun e borxhit të pashlyer në regjistrat e administratës tatimore e doganore dhe nxit pagesën vullnetare të detyrimeve të reja.

Gjithashtu, efektet e pritshme janë të shumëfishta:

1. Pritet të rriten të ardhurat nga pagesa e pjesshme e detyrimeve;
2. Të përmirësohet klima e biznesit;
3. Të ulët konflikti administrativ dhe gjyqësor, si dhe;
4. Të përmirësohen marrëdhëniet ndërmjet tatimpaguesve dhe institucioneve fiskale të vendit.

Projektligji është në përputhje të plotë me objektivat e qeverisë për rritjen e formalizimit të ekonomisë, përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjen e të ardhurave buxhetore përmes nxitjes së pagesës së detyrimeve aktuale. Ai përfaqëson një instrument të rëndësishëm politikash publike, që synon të krijojë një ambient më të favorshëm për zhvillimin ekonomik dhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe biznesit. Në këtë mënyrë, projektligji mbështet reformat strukturore të ndërmarra nga qeveria dhe kontribuon në arritjen e objektivave të saj strategjike për zhvillimin ekonomik të vendit.

Borxhi tatimor:

Sipas një analize të përgjithshme të administratës tatimore për gjendjen e borxhit

deri më 31.12.2024, situata e detyrimeve tatimore të papaguara rezulton, si më poshtë vijon:

- Në total administrata tatimore ka 202 387 tatimpagues debitorë me detyrime tatimore të papaguara, në shumën 162 535 463 mijë lekë;
- 81 830 tatimpagues debitorë (ose 40 %) janë aktivë me detyrime tatimore të papaguara, në shumën 41 552 427 mijë lekë (ose 26%), ndërsa 120 557 tatimpagues debitorë (ose 60%) janë pasivë me detyrime tatimore të papaguara, në shumën 120 983 035 mijë lekë (ose 74%).

Mosha e detyrimeve tatimore të papaguara deri më 31.12.2024, sipas vjetërsisë, janë, si më poshtë vijon:

- Detyrimet tatimore të papaguara mbi 10 vjet janë në shumën 29.6 miliardë lekë (ose 18 %);
- 5 deri në 10 vjet, në shumën 75.1 miliardë lekë (ose 46 %);
- 0 deri në 5 vjet, në shumën 57.8 miliardë lekë (ose rreth 36%).

Detyrimet tatimore të papaguara, ndarë sipas viteve dhe llojit të tatimit, paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Periudha	Mosha	Detyrim tatimor	Penalitete	Interesa	Totali
.....- 2014	Mbi 10 vjet	17,052,735	10,838,865	1,722,385	29,613,985
	TVSH brend	6,367,898	4,268,554	998,933	11,635,385
	Tatimfitimi	4,202,663	1,792,547	225,243	6,220,453
	TAP	462,358	123,124	90,124	675,606
	T.Nacionale DPT	-	-	-	-
	Kontribute DPT	3,475,688	838,376	217,226	4,531,289
	Të tjera	2,544,129	3,816,264	190,859	6,551,252
2015-2019	5-10 vite	45,227,074	26,698,683	3,201,323	75,127,080
	TVSH brend	14,326,116	9,681,294	1,019,286	25,026,696
	Tatimfitimi	11,839,907	7,734,521	1,231,086	20,805,514
	TAP	583,117	152,785	104,291	840,193
	T.Nacionale DPT	8,219,217	2,808,720	243,361	11,271,299
	Kontribute DPT	7,126,967	1,623,649	368,357	9,118,973
	Të tjera	3,131,751	4,697,713	234,942	8,064,405
2020-2024	1-5 vite	36,128,330	18,904,615	2,761,454	57,794,398
	TVSH brend	12,298,723	7,335,579	872,574	20,506,876
	Tatimfitimi	12,506,077	6,511,221	1,135,920	20,153,218

	TAP	820,505	190,851	136,706	1,148,063
	T.Nacionale DPT	32,594	11,138	965	44,697
	Kontribute DPT	8,455,056	1,832,709	464,097	10,751,862
	Të tjera	2,015,375	3,023,116	151,192	5,189,683
TOTALI		98,408,139	56,442,163	7,685,161	162,535,463

Detyrimet tatimore të papaguara ndarë në detyrim, gjobë dhe interesa deri më datë 31.12.2024, janë:

- detyrimet principale, në shumën 98 408 139 mijë lekë (ose 60%);
- gjobat, në shumën 56 442 163 mijë lekë (ose 35%);
- interesat në shumën 7 685 161 mijë lekë (ose 5%).

Borxhi doganor:

Sipas një analize të përgjithshme të administratës doganore, detyrimet doganore të papaguara deri më 31.12.2024 janë, gjithsej, 48 588 510 mijë lekë me 4 684 raste dhe ndahen në zëra, si më poshtë vijon:

- Borxhi doganor 13 100 069 mijë lekë (ose 27%);
- Penalitete 26 561 081 mijë lekë (ose 55%);
- Kamatëvonesa 8 927 360 mijë lekë (ose 18%).

Mosha e detyrimeve doganore të papaguara deri më datë 31.12.2024, sipas vjetërsisë janë, si më poshtë vijon:

- Detyrimet doganore të papaguara mbi 10 vjet janë në shumën 25 763 570 mijë lekë;
- 5 deri në 10 vjet, në shumën 18 284 590 mijë lekë;
- 1 deri në 5 vjet, në shumën 4 540 349 mijë lekë.

Këto të dhëna mbi detyrimet doganore të papaguara, ndarë sipas viteve dhe llojit të tatimit në mijë lekë, jepen dhe në tabelën e mëposhtme:

Periudha	Mosha	Detyrim	Penalitete	Interesa	TOTAL
.....- 2014	Mbi 10 vjet	6,371,700	13,451,890	5,939,980	25,763,570
	TVSH imp	1,264,245	3,866,528	2,209,080	7,339,853
	Akciza	4,525,596	9,553,568	3,520,682	17,599,846
	Renta	-	-	-	-
	T.Doganore	581,859	31,794	210,218	823,871
2015-2019	5-10 vite	5,651,190	9,788,370	2,845,030	18,284,590
	TVSH imp	1,110,750	3,589,141	1,088,185	5,788,076
	Akciza	4,245,434	6,128,930	1,726,669	12,101,033
	Renta	-	-	-	-
	T.Doganore	295,006	70,299	30,176	395,481
2020-2024	1-5 vjet	1,077,180	3,320,820	142,350	4,540,350
	TVSH imp	702,807	2,993,932	107,251	3,803,990
	Akciza	201,268	199,450	30,755	431,473
	Renta	-	-	-	-

	T.Doganore	173,105	127,438	4,344	304,887
TOTAL		13,100,070	26,561,080	8,927,360	48,588,510

Detyrimet doganore të papaguara deri më datë 31.12.2024, sipas llojit, ndahen si më poshtë vijon:

- TVSH në import 16 931 919 mijë lekë (ose 35%);
- Akciza 30 132 152 mijë lekë (ose 62%);
- Taksa Doganore 1 524 239 mijë lekë (ose 3%).

Detyrimet e akcizës të papaguara të kontabilizuar nga administrata tatimore, nga viti 2010 deri më 1 tetor 2012, dhe të trashëguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave janë në shumën 13 982 713 mijë lekë me 29 raste, ndarë në zëra si më poshtë vijon:

- Borxhi doganor 3 927 754 mijë lekë;
- Penalitet 7 306 821 mijë lekë;
- Kamatëvonesa 2 748 138 mijë lekë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDËS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 15 nene:

Neni 1 përcakton objektin e ligjit, i cili parashikon kushtet për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore të papaguara në sistemin tatimor “*e-tax*” ose jashtë tij dhe të detyrimeve të pagueshme në doganë.

Neni 2 parashikon përkufizimet në kuptim të këtij projektligji.

Neni 3 parashikon tatimpaguesit/subjektet, që përfitojnë në kuadër të këtij projektligji, të cilët janë tatimpaguesit e regjistruar në regjistrin aktiv, pasiv, të çregjistruar ose me statuse të tjera në sistemin tatimor “*e-tax*”, për detyrime

tatimore ndaj administratës tatimore dhe subjektet debitore ndaj administratës doganore.

Neni 4 parashikon tatimpaguesit/subjektet, që nuk përfitojnë në kuadër të këtij projektligji, të cilët janë tatimpaguesit/subjektet që kanë detyrime tatimore/doganore, të cilat janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale ose janë në proces gjyqësor apo hetimi në fushën tatimore dhe/ose doganore, në kuptim të legjislacionit të fushës përpara ose gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij ligji.

Neni 5 parashikon fshirjen e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara që u përkasin periudhave deri më 31 dhjetor 2014, përveç kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Për këto të fundit, parashikohet fshirja ose shuarja e dënimeve administrative dhe kamatëvonesave për periudhat deri më 31 dhjetor 2014, duke përfshirë edhe të vetëpunësuarit në bujqësi, por pa përfshirë kontributin. Po ashtu, ky nen parashikon faljen e gjobave dhe kamatëvonesave në rastet kur është paguar principali.

Neni 6 parashikon mundësinë për shuarje të pjesshme të detyrimeve për periudhën 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2019, me kusht që tatimpaguesi të paguajë një pjesë të përcaktuar të detyrimit brenda afateve të përcaktuara në të. Për këtë periudhë, nëse paguhet 50% e detyrimit njëherësh, brenda datës 30.6.2026, pjesa tjetër fshihet/shuhet, ndërsa nëse zgjidhet që pagesa të bëhet brenda datës 31.12.2026 të 75% të detyrimit, përfitohet fshirja/shuarja e pjesës së mbetur prej 25% të detyrimit. Në të dyja rastet, gjobat dhe kamatëvonesat për periudhat përkatëse fshihen plotësisht.

Gjithashtu, edhe në rastin kur është paguar principali dhe tatimpaguesi ka detyrime të papaguara vetëm gjoba dhe kamatëvonesa në llogarinë e tij, falen gjobat dhe kamatëvonesat. Për detyrimet e periudhës nga data 1 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2024, fshirja e gjobave dhe kamatëvonesave është e kushtëzuar me pagesën e plotë të detyrimit brenda datës 31.12.2026. Gjithashtu, shuhet dënimet administrative (gjobat dhe kamatëvonesat) për sigurimet shoqërore e shëndetësore, që u përkasin periudhave tatimore, nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2024, që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit, përfshirë të vetëpunësuarit në bujqësi, me kushtin që të paguhet 100% kontributi, brenda datës 31.12.2026.

Neni 7 parashikon fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore të tjera, të cilat janë për:

- tatimpaguesit persona fizikë ose juridikë, që rezultojnë të çregjistruar në QKB ose me vendim gjykate apo që janë të çregjistruar në administratën tatimore deri më 31.12.2024;
- dënimet administrative (gjobat) tatimore të llogaritura automatikisht nga

sistemi për deklarim të vonuar, sipas ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, deri më 31.12.2024, përfshirë edhe dënimet që lidhen me afatin e deklarimit të të punësuarve;

- dënimet administrative (gjobat) për mosdeklarim në afat për deklarata të padorëzuara, që u përkasin periudhave deri më 31.12.2024, me kusht që çdo deklarata e padorëzuar, të dorëzohet deri në datën 30.06.2026;
- dënimet administrative (gjobat) për dorëzim të vonuar të vendimit për destinimin e rezultatit dhe dorëzim me vonesë të pasqyrave financiare;
- gjobat dhe interesat e gjeneruara në sistem, nga ndryshimi i listëpagesave për periudhat e kaluara, që rrjedhin nga zbatimi i një akti ligjor apo nënligjor me efekt prapaveprues apo zbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë.

Neni 8 parashikon se tatimpaguesit, që kanë tepricë kreditore të TVSH-së ose të një tatimi tjetër, përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore, pas kompensimit (zvogëlimit) të tepricës deri në masën e tatimit të papaguar. Kompensimit nuk i nënshtrohen detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Nenet 9 dhe 10 parashikojnë shuarjen e detyrimeve të pagueshme në doganë, duke aplikuar të njëjtat parime, si për detyrimet tatimore. Kështu për detyrimet e papaguara deri më 31 dhjetor 2014 parashikohet fshirja/shuarja e plotë e detyrimit, ndërsa ofrohet mundësia për fshirje/shuarje të pjesshme të detyrimeve për periudhën 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2019, me kusht që tatimpaguesi të paguajë një pjesë të përcaktuar të detyrimit brenda afateve të përcaktuara në projektligj. Për këtë periudhë, nëse paguhet 50% e detyrimit njëherësh, brenda datës 30.6.2026, pjesa tjetër fshihet/shuhet, ndërsa, nëse paguhet brenda datës 31.12.2026 të 75% të detyrimit, përfitohet fshirja/shuarja e 25% të detyrimit. Në të dyja rastet, gjobat dhe kamatëvonesat për periudhat përkatëse fshihen plotësisht. Për detyrimet e periudhës nga 1 janar 2020 deri në 31 dhjetor 2024, fshirja e gjobave dhe kamatëvonesave është e kushtëzuar me pagesën e plotë të detyrimit brenda datës 31.12.2026.

Neni 11 përfshin edhe detyrimet që janë në proces ankimi administrativ apo gjyqësor, duke i dhënë mundësinë tatimpaguesit të përfitojë nga dispozitat e ligjit, nëse heq dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës administrative kompetente. Projektligji përjashton nga përfitimi nga dispozitat lehtësuese të tij, tatimpaguesit/subjektet, që kanë detyrime tatimore/detyrime të pagueshme në doganë, për të cilët ka vendim gjyqësor të formës së prerë të gjykatës administrative për këto detyrime ose vendim gjyqësor të shkallës së parë administrative me palë fituese administratën doganore/tatimore, në kuptim të legjislacionit të fushës.

Neni 12 përcakton se tatimpaguesit/subjektet, për të cilët fshirja/shuarja e

detyrimin aplikohet me kusht, nuk përfitojnë fshirje/shuarje të detyrimit nëse nuk përmbushin kushtet brenda afateve të përcaktuara në projektligj. Gjithashtu, për çdo tatimpagues/subjekt, që përfiton ose jo nga fshirja/shuarja e detyrimeve, organi përkatës nxjerr një akt administrativ për këtë qëllim, duke njoftuar edhe tatimpaguesin.

Neni 13 përcakton organet zbatuese dhe afatet për fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë. Gjithashtu, ky nen saktëson se ky ligj i shtrin efektet nga data 1 janar 2026, sipas përcaktimeve të nenit 15, deri më 31.12.2026.

Neni 14 përcakton afatin për nxjerrjen e udhëzimit të ministrit të Financave, në zbatim të këtij projektligji.

Neni 15 parashikon se ky ligj botohet në “Fletoren zyrtare” dhe i fillon efektet në datën 1 janar 2026.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen administrata tatimore qendrore/vendore, administrata doganore dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon kushtet për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore të papaguara ndaj administratës tatimore qendrore në sistemin tatimor “e-tax” ose jashtë tij dhe të detyrimeve të pagueshme në doganë. Bazuar në eksperiencat e zbatimit të ligjeve të faljes më përpara, është parashikuar që për vitin 2026, në total nga të dyja administratat, priten të arkëtohen rreth 3.7 miliardë lekë nga zbatimi tij.

KËSHILLI I MINISTRAVE

